

Date 27.03.2026

Procesverbal - Tipi i kontratës - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i procedurës: “ **Blerje materiale elektrike dhe mekanike** ”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Materiale elektrike 31681410-0 Pjese Mekanike 44316400-2

Vlera e fondit limit: : 6.783.333 (gjashtë milion e shtatëqind e tetëdhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar me VKM-në nr.714, datë 24.11.2021 autoriteti/enti kontraktor UKT sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3 përkatësisht në vlerën vlerën vlerën 135.666,66 (njqind e tridhjetë e pese mije e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë presje gjashtëdhjetë e gjashtë) (e zbatueshme në rastin e procedurave të prokurimit me një vlerë më të lartë se sa prokurimi me vlerë të vogël).*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit.

2.2 Kapaciteti ekonomiko-financiar

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023, 2024 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të fondit limit.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

2.2.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3(tre) viteve të fundit (2022, 2023, 2024) të certifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar.

2.2.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2025 të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas ligjit nr.9632 datë 30.10.2006) “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar; **(lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për vitin 2025).**

(Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime). Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Shënim: OE duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet ligjore, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuar për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j”

të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2025 sipas kësteve të parashikuara në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 si dhe vendimeve respektive të Këshillave Bashkiakë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Shënim: Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Referuar sa mësipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vërtetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2024 sipas kësteve prane bashkise/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuar

sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,

- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe mallrat e furnizuara

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufirit të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

2.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Certifikuar sipas standardeve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:

- a) Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 (**ose ekuivalente**) (e vlefshme). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave që do të marre persiper sipas akt-marreveshjes).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe bazuar në nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe me rekomandimin e APP, datë 20.03.2018, prot 3341/1.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të dëshmojnë i plotësojnë kërkesat e cilësisë për mallrat që do të furnizohen, e rrjedhimisht është e drejtë e AK t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të dëshmojnë i plotësojnë kërkesat e cilësisë, e rrjedhimisht është e drejtë e AK t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar.

ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i

menaxhimit për cilësi nga furnizuesi, fokusin e klientit, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencen/profesionalizmin e punonjësve, procesi i menaxhimit (për prodhim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për mallrat dhe shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

2.5. Operatori ekonomik duhet te paraqese:

- Autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi për mallrat e kërkuara. Në rast se do të paraqitet kjo e fundit duhet të vertetohet lidhja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëbsite, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në ligjin nr.162/2020, neni 73 datë 23.12.2020”Për Prokurimin Publik”, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe me rekomandimin e APP, datë 20.03.2018, prot 3341/1.

Njësia e Prokurimit gjykon se kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktor mbi paraqitjen e Autorizimit të Prodhuesit ose nga Distributori i Autorizuar nga Prodhuesi është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore të sipërcituara.

Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallrave të furnizuara, e rrjedhimisht mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me origjinën e mallrave të lëshuara direkt nga prodhuesi.

Pra nëpërmjet vendosjes së kriterit të sipërpërmendur AK garantohet dhe fiton siguri se operatori ekonomik kontraktues do të furnizojë dhe do të përmbushë kontratën me sukses

2.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog nga kompania prodhuese për të gjitha mallrat objekt prokurimi, ku të vërtetojë përputhjen e plotë të mallrave që ofron me specifikimet teknike të kërkuara. Në rast se katalogjet janë në gjuhë të huaj atëherë duhet të paraqiten të perkthyer në gjuhën shqipe

Argumentimi Vendosja e kriterit të sipërcituar është vënë në mbështetje të nenit 40 pika 6 germa (b) të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” I ndryshuar parashikohet shprehimisht.... Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

b) fotografitë apo katalogjet teknike;

Paraqitja e katalogëve të prodhuesve është e nevojshme në funksion të verifikimit të përpuethshmërisë së produkteve me specifikimet teknike të AK me qëllim realizimin

2.7 Ofertuesi duhet të dorëzojë dokumentin e titulluar “Ofertë Teknike” i paraqitur nga Autoriteti Kontraktor në formën e një table (pjesë e dokumentacionit të specifikimeve teknike), kërkesat e të cilit duhet të plotësohen rigorozisht nga Ofertuesi për të gjithë artikujt e Listës.

Dokumenti “Ofertë teknike” duhet të përmbajë të dhënat si më poshtë:

Nr	Emertimi i produkteve	Emertimi kompanise prodhuese.	Emertimi i katalogut	Referenca ne katalogje	Shënimet
				KOD i produktit ose nr. Faqes ne katalog	

Emertimi i produkteve duhet të bëhet sipas listës ose preventivit të paraqitur nga AK

-“Emertimi i Katalogut të prodhuesit ose distributorit të autorizuar.

-Referenca në katalogje, kodi i produktit (në rast se mungon kodi i produktit të plotësohet nr I faqes), duke treguar kodin ose numrin e faqes së katalogut në katalogun përkatës ku autoritetit kontraktor mund të gjejë specifikimet e plota teknike të ofertuesit të cilat duhet të përputhen me specifikimet e AK.

- Në fushën “SHENIM” OE mund të shkruaj sqarime të ndryshme në lidhje me produktet e ofruara.

Shënim: Hartimi dhe plotësimi i kërkesave të Ofertës Teknike më sipër, kërkohet që të kryhet nga vete ofertuesi, për të vlerësuar në këtë mënyrë nëse, produktet që ofrohen të jenë në përputhje me ato që kerkohen prej Autoritetit Kontraktor në DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në ligjin nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe me rekomandimin e APP, datë 20.03.2018, prot 3341/1, si dhe njoftimit të APP-së nr.prot 7459/4, datë 25.05.2021.

Vendosja e kriterit të mësipërm mbi paraqitjen e certifikatës origjinale të origjinës së mallrave në momentin e dorëzimit të mallrave ka për qëllim për të vërtetuar origjinën e mallit të ofertuar, për të garantuar se produktet do jenë të njëjta të të njëjtit prodhues që do të paraqesë në sistemin elektronik si dhe për të bërë të mundur gjurmimin e prodhuesit, emri dhe adresa e të cilit duhet të jete e njëjta me emrin dhe adresën e stampuar në trupin e produktit, për të shmangur falsifikimin e produkteve.

2.8 Operatori ekonomik duhet te paraqese certifikata ose raporte testimi që vertetojne permbushjen e standarteve te kerkuara ne specifikimet teknike

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 8, gërma b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për tu siguruar se operatori do të përmbush kërkesat e AK

Ky kriter është i domosdoshëm pasi materialet elektrike janë produkte që lidhen drejtpërdrejt me **sigurinë teknike, funksionimin korrekt të rrjeteve dhe mbrojtjen e jetës dhe pronës.**

Certifikatat (p.sh. CE, ISO, ose raporte testimi nga laboratorë të akredituar) garantojnë që produktet janë prodhuar dhe testuar sipas standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare.

Ato sigurojnë përputhshmërinë me parametrat teknikë të kërkuar (rezistencë, izolim, tension pune, jetëgjatësi, etj.).

Në mungesë të këtyre dokumenteve, ekziston rreziku i furnizimit me materiale jo cilësore, të cilat mund të shkaktojnë defekte, ndërprerje energjie apo edhe incidente të rrezikshme.

Për rrjedhojë, ky kriter vendoset për të garantuar cilësinë dhe sigurinë e materialeve të furnizuara dhe për të mbrojtur interesin publik.

2.9 Operatori ekonomik duhet te paraqes nje deklarate ,me anë te së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit në adresën e përcaktuar nga autoriteti kontraktor.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 8, gërma b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për tu siguruar se operatori do të përmbush kërkesat e AK

Ky kriter është i justifikuar për shkak të natyrës së mallrave dhe nevojës për dorëzim të sigurt dhe në kohë:

Materialet elektrike shpesh janë **produkte të ndjeshme ndaj dëmtimeve fizike dhe kushteve të transportit** (lagështirë, goditje, deformime).

Transporti i tyre kërkon **kujdes të veçantë dhe përgjegjësi nga operatori ekonomik**, për të garantuar që mallrat të mbërrijnë në gjendje optimale.

Deklarata e transportit siguron që operatori merr përgjegjësi të plotë për dorëzimin deri në destinacion, duke shmangur vonesa apo kosto shtesë për autoritetin kontraktor.

Ky kriter lidhet gjithashtu me **ekzekutimin korrekt të kontratës**, pasi furnizimi nuk konsiderohet i përfunduar pa dorëzimin fizik në vendin e përcaktuar.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Në të gjitha rastet kur përmendet çertifikatë ,markë,emër i veçantë ,patentë,vizatim ose tip,origjine specifike,prodhues ose sipërmarrës pranohet edhe ekuivalent i tyre

II. ARGUMENTIM

MBI SPECIFIKIMET TEKNIKE

Argumentim mbi specifikimet teknike

Specifikimet teknike të përcaktuara për materialet elektrike objekt prokurimi janë hartuar në funksion të natyrës së përdorimit të tyre në instalime dhe pajisje industriale, ku kërkohet nivel i lartë sigurie, besueshmërie dhe qëndrueshmërie në punë. Këto materiale do të përdoren në kushte operative që kërkojnë pajisje të certifikuara, me parametra të qartë teknikë dhe me performancë të garantuar.

Përcaktimi i karakteristikave si: tensioni i punës, rryma nominale, numri i poleve, klasa e mbrojtjes IP, diapazoni i temperaturës së funksionimit, qëndrueshmëria mekanike dhe elektrike, kapaciteti për qark të shkurtër, standardet e prodhimit dhe kërkesat për montim, është i nevojshëm për të siguruar që materialet e furnizuara të jenë të përshtatshme për përdorim industrial dhe të përputhshme me rrjetet, panelet, motorët dhe pajisjet ku do të instalohen.

Këto specifikime janë vendosur për të garantuar:

Së pari, përputhshmërinë funksionale të materialeve me parametrat e rrjetit elektrik dhe të pajisjeve ekzistuese. Materialet si lëshuesit, automatët, reletë, kabllot, klemat dhe aksesoret duhet të punojnë në tensionet, rrymat dhe kushtet e ngarkesës për të cilat parashikohen, në mënyrë që të mos krijohen defekte, mbinxehje, ndërprerje apo dëmtime të pajisjeve.

Së dyti, sigurinë teknike gjatë shfrytëzimit. Përcaktimi i standardeve përkatëse, klasës së mbrojtjes, rezistencës ndaj impulseve, qarkut të shkurtër, mbingarkesës, temperaturës dhe faktorëve mjedisorë synon të garantojë që produktet të jenë të sigurt për personelin dhe për infrastrukturën elektrike.

Së treti, jetëgjatësinë dhe qëndrueshmërinë e materialeve në kushte pune industriale. Kërkesat për cikle pune mekanike dhe elektrike, rezistencën ndaj goditjeve, vibrimeve, konsumit, si dhe montimin në kushte të caktuara ambientale, janë të nevojshme për të shmangur zëvendësimet e shpeshta dhe kostot shtesë të mirëmbajtjes.

Së katërti, standardizimin dhe kontrollin e cilësisë. Referimi në standarde të njohura kombëtare dhe ndërkombëtare ose ekuivalente me to siguron që produktet të jenë të testuara dhe të prodhuara sipas kërkesave të njohura teknike, duke mundësuar verifikim objektiv të cilësisë dhe krahasueshmëri ndërmjet ofertave.

Së pesti, garantimin e performancës së qëndrueshme dhe të pandërprerë të sistemit elektrik. Në pajisjet industriale, veçanërisht ato që komandojnë motorë, linja shpërndarjeje dhe qarqe fuqie, çdo devijim nga parametrat teknikë të kërkuar mund të sjellë mosfunksionim, ulje të efikasitetit, rrezik për dëmtim të pajisjeve dhe ndërprerje të procesit të punës.

Për këtë arsye, specifikimet teknike nuk janë vendosur për të kufizuar konkurrencën, por për të siguruar që mallrat e ofruara të përmbushin kushtet minimale të nevojshme të sigurisë, funksionalitetit, qëndrueshmërisë dhe cilësisë, në raport me destinacionin e tyre të përdorimit.

Në çdo rast, referimi në standarde është bërë duke pranuar edhe produkte **ekuivalente**, me qëllim respektimin e parimit të mosdiskriminimit dhe të konkurrencës së hapur, për sa kohë operatori ekonomik provon se produkti i ofertuar plotëson në thelb të njëjtat kërkesa teknike dhe funksionale.

NJËSIA E PROKURIMIT: